

VENDIM
Nr.983, datë 10.11.2010

PËR PËRCAKTIMIN E KOMPETENCAVE TË INSTITUTIT TË MONUMENTEVE TË KULTURËS “GANI STRAZIMIRI” DHE RIORGANIZIMIN E DISA INSTITUCIONEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Instituti i Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri”, më poshtë i quajtur IMK, është institucion qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. IMK-ja ka për objekt të veprimtarisë së tij mbrojtjen, konservimin, restaurimin, rijetëzimin dhe propagandimin e trashëgimisë kulturore materiale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”.

3. IMK-ja për realizimin e objektivave të veprimtarisë, sipas pikës 2 të këtij vendimi, ka këto detyra:

a) Harton programet dhe projektet në fushën e trashëgimisë kulturore dhe bashkërendon punën për zbatimin e tyre në nivel kombëtar dhe vendor.

b) Propozon ndryshime në legjislacionin për trashëgiminë kulturore me porosi dhe në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

c) Ndjek zbatimin e standardeve e të kriterëve për gjurmimin, mbrojtjen, evidentimin, studimin, konservimin dhe restaurimin e monumenteve të kulturës dhe të veprave të artit.

ç) Propozon politika nxitëse dhe mbështetëse për zhvillimin e trashëgimisë kulturore e të investimeve private në këtë fushë.

d) Bashkërendon punën në fushën e trashëgimisë kulturore, ndërmjet institucioneve të tjera shtetërore dhe ndërkombëtare, shoqërisë civile dhe sektorit privat.

dh) Kryen dhe mbikëqyr ndërhyrjet restauruese.

e) Ndjek dhe mbikëqyr zbatimin e kriterëve të organizimit muzeor të ikonave dhe të atyre arkeologjike.

ë) Ndjek dhe mbikëqyr zbatimin e kriterëve të administrimit të fondeve të luajtshme dhe të paluajtshme të monumenteve të kulturës.

f) Kryen inventarizimin, ruajtjen, propagandimin dhe studimin e pasurive kombëtare në fushën e monumenteve të kulturës.

g) Harton dhe zbaton programet e kualifikimit të specialistëve të fushës së monumenteve të kulturës.

gj) Drejton, në bashkëpunim me UNESCO-n, shkollën e Restaurimeve të Monumenteve të Kulturës.

4. IMK-ja përfaqësohet në qarqe nga drejtoritë rajonale të kulturës kombëtare (DRKK), me përjashtim të Parkut Kombëtar të Butrintit dhe Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Sarandë. Të gjitha këto institucione organizohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. IMK-ja, nëpërmjet DRKK-ve, kontrollon punimet e drejtpërdrejta restauruese, realizon kontrollin e ruajtjen e monumenteve, konservimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve restauruese nga të tretët, drejtimin e qendrave historike dhe të parqeve arkeologjike, si dhe funksionimin e muzeve tipologjike.

5. Drejtori i IMK-së, drejtorët e DRKK-ve, të parqeve arkeologjike në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, emërohen, lirohen ose shkarkohen nga detyra me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në përputhje me vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit”.

6. IMK-ja përcakton kriteret e veçanta për punonjësit që angazhohen në veprimtaritë me trashëgiminë kulturore. Marrëdhëniet e punës rregullohen në bazë të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Të drejtat dhe detyrat e stafit drejtues dhe të punonjësve që varen prej tyre përcaktohen në rregulloret e brendshme të IMK-së.

7. Personeli teknik i DRKK-ve dhe i organizmave të tyre është pjesë e drejtorisë përkatëse në IMK.

8. Çdo akt nënligjor që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

9. Ngarkohet ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha